

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama prezanton 6 programet e reja të strehimit: Nga banesat sociale tek ato për personat me aftësi të kufizuara – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/rama-prezanton-6-programet-e-reja-te-strehimit-nga-banesat-sociale-te-ato-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 12:09:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 12:07:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	79f2d1219d3161f421a5534aedfb7c3c49560a8b6e756211d5834d3905fdd34f
TEKSTI	0320af55103be7fe3494c28bc91234720d4b17d0d0b538d55f3f51e2446dba00
PAMJA	67839300c32ffdb4ab29ed8a1159a56e0d4ffe26d52c67cc3330c8bec06c1285

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	de9ab68709b71c9f2b4c10172b4a51255ffb7f9eff2a7dd65ba04200c28d561b
E MËPARSHMJA	216567f36fd43eeb4a5cafab2290de72515c37a76426eaad59038aa92f53582
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/de9ab68709b71c9f2b4c10172b4a51255ffb7f9eff2a7dd65ba04200c28d561b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Kryeministri Edi Rama ka prezantuar gjashtë programet e reja që do të përfshihen në Programin Kombëtar të Strehimit për Shqipërinë, "Rilindja 2.0".

I pranishëm në eventin e prezantimit të programit, Rama tha se qeveria do t'i adresojë të gjashtë programet së bashku, duke ndryshuar qasjen ndaj politikave të strehimit.

Programi i parë është ai i banesave sociale me qira. Sipas Ramës, bëhet fjalë për një skemë të njohur, e cila është përdorur prej vitesh, por që tashmë do të zbatohet në një mënyrë të re.

"Janë 6 programe të reja, të cilat ne do t'i adresojmë të gjitha së bashku. Programi i parë është programi i banesave sociale me qira. Është një skemë e miënjohur e përdorur në vite, por të cilën ne do ta qasim në një mënyrë të re."



5 Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor:
Një vit të mbarë për nxënësit,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

Programi i dytë lidhet me banesat me kosto të ulët. Rama shpjegoi se në këtë skemë parashikohet subvencionimi nga shteti i kredisë, në mënyrë që banesa e kredituar të përfshihet në kategorinë e banesave me kosto të ulët.

“Banesa me kosto të ulët që është një tjetër program dhe lidhet me subvencionin nga ana e shteti të kredisë, duke pasur parasysh që banesa e kredituar të hyjë në kategorinë e banesave me kosto të ulët. Për këtë ka një kategorizim të mirëpërcaktuar me kriteret e mirëpërcaktuara.”



Një tjetër program do të fokusohet te përmirësimi i banesave ekzistuese për grupet vulnerabël. Në këtë kuadër parashikohet edhe një projekt i veçantë infrastrukturor për përshtatjen e banesave të caktuara si banesa sociale.

“Përmirësimi i banesave ekzistuese për grupet vulnerabël si dhe një projekt i veçantë infrastrukture për të adaptuar banesa të caktuara si banesa sociale.”



Rama u ndal edhe te zhvillimi i zonave të strehimit, duke theksuar se ky program nuk do të kufizohet vetëm te familjet në nevojë, por do t'u drejtohet të gjitha shtresave të shoqërisë.

Sipas kryeministrit, synimi është që të shmanget krijimi i zonave të izoluara vetëm për familjet me të ardhura të ulëta dhe të ndërtohen hapësira të denja banimi për të gjithë.

“Zhvillimi i zonave të strehimit. Këtu nuk flasim vetëm për banesa sociale, vetëm për ata në nevojë, por flasim për të gjitha shtresat e shoqërisë. Nuk duam të ndërtojmë një bllok banimi vetëm për njerëz të varfër, por dua të kemi blloqe banimi dizniitoze për të gjitha shtresat.”



Programi i pestë është ai i banesave të përkohshme. Rama tha se do të ndërtohen banesa të tilla për njerëzit që preken nga fatkeqësitë natyrore, duke përmendur përmbytjet dhe zjarret si disa prej situatave me të cilat mund të përballen qytetarët.

“Programi tjetër është programi i banesave të përkohshme. Do të na duhet të ndërtojmë banesa të përkohshme për njerëzit e prekur nga fatkeqësitë natyrore. Këto të fundit janë bashkëudhëtare të jetës së këtij planeti. Përmbytjet, zjarret.”

Ndërsa programi i gjashtë do të fokusohet te banesat e veçanta, të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

“Programi 6 është programi i atyre që mund t’i quajme banesa të veçanta. Janë banesa të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.”

#rama

#Strehim



Yhuliana Zhulaku



Vazhdo të lexosh



POLITIKË

Begaj uron nisjen e vitit të ri shkollor...


Xhuljana Zhuleku 6 minuta më parë



POLITIKË

"Nuk po na lejohej të marrim nga qesja..."

Xhuljana Zhuleku Dje 21:49



POLITIKË

"Të dëgjojmë dhe të trajtojmë çdo..."

Xhuljana Zhuleku Dje 20:03



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale